



BASHKIA KORÇË

NR 6918 PROT
DATA 14/07/2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE
MENAXHIMIT TË KONTRATAVE TË INFRASTRUKTURËS

Nr. _____ prot.

Korçë, më _____.2025

Lënda: THIRRJE E MBLEDHJES JASHTË RRADHE TË KËSHILLIT

KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË

Bulevardi Shën Gjergji, Lgj.12, 7001, Korçë

E nderuar Znj. Kryetare!

Në bazë të nenit 53, pika 3, germa a) të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” kërkoj thirrjen e një mbledhje jashtë rradhe të Këshillit Bashkiak Korçë për të shqyrtuar materialin për “Miratimin marrëveshjes të bashkëpunimit për zbatimin e projektit të investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronës shtetërore, nënprojektit “Rijetëzimi i stadiumit Skënderbeu Korçë dhe zonës urbane rreth tij” dhe vendosjen në dispozicion të projektit, të pronave në pronësi Bashkisë Korçë.

Shqyrtimi i kësaj drafti marrëveshje në Këshillin Bashkiak duhet ti paraprijë mbledhjes së rradhës të Këshillit të Ministrave që zhvillohet në dt 24.07.2025, ku do të shqyrtohen dhe projekt-vendimet për autorizimin e Korporatës të Investimeve Shqiptare, “Për zhvillimin e pronave shtetërore” për realizimin e projekti të investimit “Rijetëzimi i Kompleksit Sportiv Skënderbeu Korçë, Stadiumit dhe zonës Urbane përreth”.

Për këto arsye, është e domosdoshme që Këshilli Bashkiak të mblidhet jashtë rradhe për të shqyrtuar këtë material. Propozojmë që rendi i ditës të jetë si më poshtë:

1. Për “Miratimin marrëveshjes të bashkëpunimit për zbatimin e projektit të investimit “Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronës shtetërore”, nënprojektit “Rijetëzimi i stadiumit Skënderbeu

Korçë dhe zonës urbane rreth tij" dhe vendosjen në dispozicion të projektit, të pronave në pronësi Bashkisë Korçë.

Kërkoj miratimin tuaj për thirrjen e kësaj mbledhjeje jashtë rradhe dhe mirëpres një përgjigje të shpejtë nga ana juaj.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË

Sotirag Filo

